VENDIM
Nr.892, datë 22.12.2004

PËR PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PRONËSISË MBI TOKËN, QË ZIHET NGA NDËRTIMI I AEROPORTIT TË KUKËSIT, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.1, DATË 7.1.2000 TË KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionet e tokës në fshatrat Shtiqën e Krenzë, të komunave Shtiqën e Bicaj të qarkut të Kukësit, të plotësojnë dokumentacionin e pronësisë mbi tokën për familjet, që e kanë përfituar nga ligji nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar, për sipërfaqet e ndara përpara datës 7.1.2000, të cilat zihen nga ndërtimi i aeroportit të Kukësit, të miratuar me vendimin nr.1, datë 7.1.2000 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Ngarkohet komisioni i tokës së qarkut të Kukësit të ngrejë komisionin e përbashkët të tokës, me përfaqësues të bashkisë së Kukësit dhe të fshatit Shtiqën, të komunës Shtiqën, për plotësimin e këtij dokumentacioni për familjet me tokë në këtë fshat dhe me banim në fshatin Kënetë.

3. Ngarkohen komisioni i tokës së qarkut të Kukësit dhe komisionet e tokës të komunave Shtiqën dhe Bicaj të verifikojnë dhe të miratojnë dokumentacionin e pronësisë mbi tokën, të plotësuar nga komisionet përkatëse, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi.

4. Komisionit të tokës së qarkut të Kukësit t'i jepet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për shpërblimin e komisionerëve të qarkut, të komunave, të bashkisë e të fshatrave, si dhe të specialistëve, të angazhuar në përditësimin e dokumentacionit dhe të sipërfaqeve të tokës.

5. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit, i cili të ndahet si më poshtë vijon:

a) Për shpërblimin e komisionerëve dhe të specialistëve të qarkut, 200 000 (dyqind mijë) lekë;

b) Për shpërblimin e komisionerëve dhe të specialistëve të komunës Shtiqën, 400 000 (katërqind mijë) lekë;

c) Për shpërblimin e komisionerëve të fshatit Shtiqën, 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) Për shpërblimin e komisionerëve të komunës Bicaj, 100 000 (njëqind mijë) lekë;

d) Për shpërblimin e komisionerëve të fshatit Krenzë, 100 000 (njëqind mijë) lekë;

dh) Për shpërblimin e komisionerëve të komisionit të përbashkët bashki-Shtiqën, 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano